

# KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 20.06. 2023, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

**PALA E PARË: Shoqëria "BIGALB GROUP" Shpk**, identifikuar me NIPT: L11521002M, Zotërues i një pjese në kapital, të barabartë me 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga Znj. Elona KOSHI, e datëlindjes 04.09.1986, lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e karte ID me numër personal I65904092M, që këtu e në vijim. "Shitësi"

**PALA E DYTË: Shoqëria "B-IDEALGROUP" shpk**, identifikuar me NIPT: M31722025S, Zotërues i një pjese në kapital, të barabartë me 49% (dyzetë e nëntë për qind) të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga Z. Vladimir Lleshaj, i datëlindjes 08.04.1978, i lindur ne Prosek, Mirëditë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i karte ID me numër personal H80408150T, që këtu e në vijim, "Shitësi"

**PALA E TRETË: Z. Ilir Saliaj**, i biri i Kadriut, i datëlindjes 13.10.1963 i lindur në Kuçovë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 033855694 dhe nr personal G31013034O, që këtu e në vijim "Blerësi"

## HYRJE

A. Shoqërisa "BIG ONE" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 16.06.2023, pajisur me nipt M31816026A, me seli në adresën *Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Zona Kadastrale Nr. 8250, Nr.Pasurie 2/258/NDN2 dhe 2/258/ND-N1, Tiranë*, me ortakë:

- |                             |   |
|-----------------------------|---|
| 1. Shoqëria "BIGALB GROUP": | Numri i Pjesëve 1 (një);<br>Pjesëmarrja në përqindje 51%; |
| 2. Shoqëria "B-IDEALGROUP": | Numri i Pjesëve 1 (një);<br>Pjesëmarrja në përqindje 49%  |

B. Palët kanë rënë dakort që një pjesë të kuotave të zotëruara nga Shitësit, të kalojnë tek Blerësi mbas firmosjes së kësaj kontrate dhe kalimit të pagesës.

C. Shoqëria "BIG ONE" shpk, dhe ortakët më sipër me vendimin Nr. 01 të datës 20.06.2023, në mënyrë të shprehur kanë dhënë aprovimin e tyre për tjetërsimin e kuotave

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

## Neni 1

### Baza Ligjore

1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;

1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryesisht nenet 72-75 të tij.

## Neni 2 Objekti

2.1 Shitësit do t'i shesin Blerësit, një pjesë të kuotave të tyre, në masën në masën e 20% të kapitalit, nga totali prej 100% (njëqind për qind) që Shitësit zotërojnë në shoqërinë BIG ONE.

2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "BIG ONE" shpk, do të zotërohet nga ortakët në si më poshtë:

1. "BIGALB GROUP" shpk: Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 40% (dyzetë për qind);
2. "B-IDEALGROUP" shpk: Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 40% (dyzetë për qind);
3. Z. Ilir Saliq: Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 20% (njëzetë për qind).

## Neni 3 Afati

3.1 Momenti i kalimit të kotave do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga palët.

3.2 Afati i pasqyrimit të kuotave të reja në ekstraktin e shoqërisë do të jetë një 1 (një) muaj nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

## Neni 4 Vlera e shitjes

4.1 Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 4.000,000 (katër milionë) lekë.

## Neni 5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

5.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.

5.2 Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

## Neni 6 Të tjera

6.1 Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.

6.2 Kontrata redaktohet në 3 kopje, me fuqi të njëjtë.

## PALËT:

SHITËSI  
"BIGALB GROUP" shpk  
Z. Vullnet Sinaj  
Person i Besuar  
Znj. Elona Koshi

*Elona Koshi*

SHITËSI  
"B-IDEALGROUP" shpk  
Z. Vladimir Lleshaj

*Vladimir Lleshaj*

BLERËSI  
Z. Ilir Saliq

*Ilir Saliq*

